



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 26.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 23.08.2022 të parashtruar nga OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllavi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush” me nr. të Prokurimit 613-22-7225-5-1-1

V E N D I M

I Aprovohet si pjeserisht e bazaur, kërkesa për ri-shqyrtim OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj të dt.23.08.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllavi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush” me nr. të Prokurimit 613-22-7225-5-1-1

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të Ndryshoj disa nga kërkesat e parashtruara tek kërkesa për Kapacitet teknik dhe profesional duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të dërgohet OE ankues në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sillovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush" me nr. të Prokurimit 613-22-7225-5-1-1

Pretendimi juaj i Parë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj i Parë.

Kjo kerkese e parashtruar ne NJK dhe DT eshte vendosur duke u bazuar ne projektin e lartcekur: Inxhinieri i Infrastruktures eshte me se i nevojshem per kete projekt sepse ka te beje direkt per projektin ne fjale, ndersa certifikata per menaxhim punishtesh per kete inxhinier do te largohet nga kerkesat e paraqitura nga AK.

Ky pretenim i juaji eshte pjeserisht i Bazuar.

Pretendimi juaj i Dytë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj i Dytë.

Prenimi juaj i dyte eshte i pabazuar duke e pasur parasysh vleren e projektit dhe rendesine e projektit eshte shume e nevojshme qe se paku te jete nje person i certifikuar per menaxhim punishte, nga AK kerkohet qe te rritet cilsia dhe kualiteti i punimeve dhe me persona qe jane te avancuar e certifikuar per lemite e ndertimit arrihet cilesia.

(Sqarim: duke pasuar parasysh projektet e meherhshme ju vet si OE keni te bashkangjitur kete persona te certifikuar ne projektet e kaluara)

Ky pretenim i juaji eshte i Pa Bazuar.

Pretendimi juaj i Tretë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj i Tretë.

Sa i perket kerkeses per nje person te certifikuar per elektroteknike AK vendos qe kjo pike te pranohet si e bazuar dhe do te largohet nga kerkesa.

Ky pretenim i juaji eshte i Bazuar.

Pretendimi juaj i Katër.

Pergjigje per Pretendimin e juaj i Katër.

Kjo kerkese e parashtruar ne NJK dhe DT eshte vendosur duke u bazuar ne projektin e lartcekur dhe per te rritur deshmine e mjeteve te punes dhe nuk eshte aspak diskriminuese sepse vlene per te gjithë OE njejtë. Kemi kerkuar qe per mjetet e punes qe qdo OE qe ka fature te blerjes kerkohet qe te bashkngjitet edhe Dudi doganor qe eshte blere prej shitesit sepse qdo mjete qe hyn ne doganen e Kosoves paiset me Dud Doganor.

Ky pretenim i juaji eshte i Pa Bazuar.

Pretendimi juaj i Pestë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj të Pestë

Pretendimi juaj i pestë per mjetin cilinder gome gome max 4 T eshte i pabazuar sepse kjo kerkese eshte vendosur duke u bazuar ne kete projekt dhe rendesine e tij poashtu duhet te ju njoftojme qe kjo eshte nje kerkese qe eshte perseritur edhe ne shume projekte me pare, AK vendos mjetet e punes per ato projekte qe nevojitet.

(Sqarim: duke pasuar parasysh projektet e meherhshme ju vet si OE keni te bashkangjitur kete mjet pune ne projektet e kaluara)

Ky pretenim i juaji eshte i Pa Bazuar.

Pretendimi juaj i Gjashtë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj të Gjashtë

Sa i perket kerkeses Rimorkio per terheqje te kablllove AK vendos qe kjo pike te pranohet si e bazuar dhe do te largohet nga kerkesa.

Ky pretenim i juaji eshte i Bazuar.

Pretendimi juaj i Shtatë.

Pergjigje per Pretendimin e juaj të Shtatë

Kjo kerkese per mjetin e punes makine per vendosje te bankinave e parashtruar ne NJK dhe DT eshte vendosur duke u bazuar ne vleren e projektit dhe rendesine e projektit te lartcekur edhe ju vete si OE e dini qe kualiteti i punimeve rritet duke u realizuar me makinat perkatese, ne si AK kemi kerkuar kete mjet ne shume projekte tjera te ngjshme aty ku eshte kerkuar me projekt, dhe nuk eshte risi per AK dhe per OE tjere.

(Sqarim: duke pasuar parasysh projektet e mehereshme ju vet si OE ju keni dhene po kete mjet ne shfrytzim kompanive tjera qe se perkasin kete mjet).

Sqarim: Ndryshimet do te paraqiten tek kjo procedure dhe do te shtyhet afati i hapjes sipas ligjeve te LPP-se.


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit